



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2021:276082
Datë: 11.11.2024
Numri i dokumentit: 06431716

Pzd.nr.123/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Rasim Rasimi, kryetar kolegji, Afrim Shala dhe Agim Maliqi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit M. (S.) Sh., nga fshati ..., komuna e O., me vendbanim në fshatin ..., rruga "...", për shkak se ka kryer veprën penale falsifikimi i dokumenteve zyrtare nga neni 427 par.1 lidhur me nenin 77 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën e mbrojtëses se të dënuarit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 05.11.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e mbrojtëses se të dënuarit M. Sh., për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për krime të rënda PKR.nr.783/2021 të datës 26.04.2024.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë - Departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PKR.nr.783/2021 e datës 26.04.2024, të dënuarin M. Sh., e ka shpallur fajtor për veprën penale falsifikimi i dokumenteve zyrtare nga neni 427 par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve.

Në procedurën ankimore Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për krime të rënda, me aktgjykimin PAKR.nr.391/2024 e ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ka paraqitur mbrojtësja e të dënuarit M. Sh., avokatja Fortesa Mehmeti Sylaj, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë kërkesën si të bazuar dhe t'i shqiptojë një dënim më të butë.

Prokurori i Shtetit të Kosovës në Prishtinë, me parashtresën KZJD.nr.123/2024 e datës 29.10.2024, ka propozuar që kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të refuzohet si e pabazuar. Propozim të njëjtë ka dhënë edhe Gjykata Themelore në Prishtinë, me parashtresën KP.nr.327/2024 e datës 11.10.2024, si dhe Prokurori i Themelore në Prishtinës, në mendimin PP.I.nr.118/2022 e datës 04.10.2024.

Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të nenit 431 par.1 të Kodit të Procedurës Penale (KPP), pasi që shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, propozimet e lartë cekura dhe gjeti se:

- kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit është e pabazuar.

Me dispozitën e nenit 429 të KPP-së, parashikohet se zbutja e jashtëzakonshme e dënimit të shqiptuar në formë të prerë lejohet kur paraqiten rrethana që nuk kanë ekzistuar në kohën kur është marrë aktgjykimi ose gjykata nuk ka ditur për to, megjithëse kanë ekzistuar, e të cilat qartazi do të çonin në shqiptimin e një dënimi më të ulët.

Gjykata Supreme e Kosovës, në përputhje me këtë dispozitë vlerëson se rrethanat që theksohen në kërkesë a kanë peshë ligjore dhe a janë të asaj natyre që do të mund të ndikojnë në një dënim më të butë, gjithnjë duke pasur parasysh peshën e veprës penale si dhe rrethanat e kryerjes së saj.

Në kërkesën e saj mbrojtësja e të dënuarit thekson se, i dënuari ka probleme shëndetësore me zemër dhe është i moshës së shtyrë. Kërkesës ia ka bashkangjitur raportet mjekësore në emër të të dënuarit të lëshuar nga Spitali i Përgjithshëm në Mitrovicë dhe Gjakovë, të viteve 2023 e 2024.

Gjykata Supreme konstatoi se nga shkresat e lëndës del se gjykata me rastin e vendosjes lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit ka vlerësuar rrethanat të cilat kanë ekzistuar në kohën e marrjes së vendimit. Si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar moshën e të dënuarit dhe gjendjen shëndetësore të tij. Nga raportet mjekësore të lëshuar në emër të dënuarit del se i dënuari ka marrë shërbim mjekësor, ku i është dhënë terapia, ndërsa gjendja e tij aktuale është stabile. Rrethanat në të cilat thirret mbrojtësja e të dënuarit në kërkesë, nuk janë të reja sepse janë marrë në konsideratë me rastin e vendosjes për dënim, nuk janë rrethana që justifikojnë zbutjen e dënimit.

Nga sa u tha, kjo gjykatë gjen se nuk janë plotësuar kushte ligjore për aprovimin e kërkesës për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit dhe konform dispozitës së nenit 431 par.7 të KPP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË
Pzd.nr.123/2024, më datë 05.11.2024

Bashkëpunëtori profesional,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Rasim Rasimi